



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSh. nr. 276/22

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetarja e OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 në përbërje prej: Z. Vedat Poterqoi- Kryetar, znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani- Anëtare si dhe z. Agon Ramadani- Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues Komuna e Gjakovës, që OSHP-ja të veproj konform nenit 99 paragrafi 2 të LPP-së, përkitazi me OE “MEGRANT ING” sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi, montimi dhe ndërtimi me material për klasën verore në SHFMU “Ukshin Miftari”, me nr. të prok: 632-22-3675-1-3-6, më datën 22.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet**, si e bazuar kërkesa e autoritetit kontraktues- Komuna e Gjakovës e dt: 06 qershor 2022, për diskualifikim sipas nenit 99.2 të LPP-së, OE “MEGRANT ING” sh.p.k me seli në Prishtinë.
- II. Diskualifikohet**, OE “MEGRANT ING” sh.p.k, me numër të biznesit: 811282136, për shkak të mos prezantimit të dokumentacionit nga ATK dhe Gjykata, dhe atë për katër

muaj, dhe se të njëjtit i ndalohet pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit publik në Republikën e Kosovës që nga data 22.09.2022 deri me 22.01.2023.

ARSYETIM

Me datën 06.06.2022, Autoriteti Kontraktues- AK- “KK-Gjakovë” ka dorëzuar në OSHP kërkesën për aplikim të masave sipas nenit 99 pika 2 të LPP-së ndaj OE “MEGRANT ING” sh.p.k -Prishtinë.

OSHP me datën 07.06.2022 ka autorizuar një ekspert shqygjashrtues për të përgatitur një rrjedhë (kronologji) të rastit.

Autoriteti kontraktues AK- “KK-Gjakovë” me datën 06.06.2022, ka parashtruar kërkesë në OSHP për të aplikuar dispozitat e nenit 99 pika 2 të LPP-së dhe nenit 26.8 të RUOPP-së ndaj OE “Migrant ING” sh.p.k-Prishtinë, me numër unik identifikues: 811282136.

Si arsye për marrjen e masave në pajtim me nenin 99.2 të LPP -së, për OE “MEGRANT ING” sh.p.k., me numër unik 811282136, rruga Ilir Sabo nr. 5 Prishtinë në kërkesën e lartcekura AK ka specifikuar: “KERKESE PER ZBATIM TE NENIT 99.2 ndaj “MEGRANT ING sh.p.k., me numër unik 811282136, rr. Ilir Soba , nr.5. Prishtinë, Kosovë. e-mail:migrant.ing@gmail.com.

Baza ligjore: Neni 99.2 dhe Neni 26.8 4 “Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare". Neni 26.8 i RUOPP përcakton:

“Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se”.

KK Gjakovë, me date 17.05.2022 dhe 27.05.2022.ne përputhje me nenin 26.8 të RUOPP, ka kërkuar nga OE "MEGRANT ING ' sh.p.k., vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë,

për aktivitetin e prokurimit "Fuqizimi, montimi dhe ndërtimi me material për klasën verore në SHMFM Ukshin Miftari", me numër identifikues: 632-22-3675-1-3-6.

1. OE ne fjalë, brenda afatit të kërkuar ligjor, nuk ka dorëzuar vërtetimin nga ATK se nuk ka obligime borxhe të tatimeve në ATK si dhe vërtetimin e lëshuar nga një Gjykatë kompetentë se kompania (biznesi) nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor.
2. KK Gjakovë, ne përputhje me nenin 26.8 RRUOP-së Ka vazhduar me tenderuesin e listuar në vendin e dytë; Me këtë kërkesë inicion procedurën për diskualifikim të OE;
3. KK Gjakovë, kërkon nga OSHP zbatimin e nenit 99.2, për arsye se OE ka paraqitur të dhëna të rreme me rastin e dorëzimit të ofertës me datë 04.05.2022, kur se bashku me oferte ka dorëzuar Deklaratën nën Betim në të cilën deklaronte OE deklaron se i përmbush kushtet e përshtatshmërisë, respektivisht nenin 65 të LPP.

Provë:

1. Kopja e njoftimit për kontratë
2. Kapja e shkresës së KK Gjakovë drejtuar OE

Organi Shqyrtues i Prokurimit me datën 06.06.2022 e ka njoftuar OE "MEGRANT ING sh.p.k. , me numër Unik 811282136, rruga Ilir Sabo nr. 5 Prishtinë, me kërkesën e AK-se, i njëjti OE me datë ka kthyer këtë përgjigje:

"Te nderuar, në vazhdim ju paraqesim sqarimet tona: Kërkesa e AK KK Gjakovë është e pa arsyeshme si dhe me tendencë të eliminimit të operatorëve ekonomik nga pjesëmarrja nëpër aktivitetet e prokurimit.

Ne kemi konkurruar në aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe ndërtimi me material për klasën verore në SHFMU "Ukshin Miftari" me nr prokurimi: 632-22-3675-1-3-6 me datën 04.05.2022 dhe ky aktivitet i prokurimit ka pasur vlefshmëri 30 ditë.

KK Gjakovë është vonuar me vlerësimin e ofertave dhe me datë 17.05.2022 na ka dërguar kërkesën për vërtetimin tatimor si dhe vërtetimin e Gjykatës kompetente.

Ne nuk ju kemi përgjigjur kësaj kërkesë për arsye se vërtetimi jonë tatimor me nr. serik: 1000866654 i datës 15.02.2022 me vlefshmëri 90 ditë i ka kaluar afati me datën 15.05.2022 andaj ne kemi hyrë në obligime të reja tatimore dhe me këtë rast nuk kemi mundur të nxjerrim Vërtetim Tatimor pa borxhe.

Autoriteti Kontraktues KK Gjakovë është dashur që pasi ne si Operator Ekonomik nuk ju kemi përgjigjur ftesës "Letër standarde për sqarimin e tenderit" deri me datën 24.05.2022 të vazhdoj me operatorin tjetër ekonomik pasi që oferta jonë është refuzuar për shkak të mos përgjigjes nga ana jonë dhe se OSHP në vendimet e veta të raste të ngjashme ka marrë vendime se Operatorët

Ekonomik mund te konkurrojne neper aktivite prokurimi por mund te hyjne ne obligime tatimore ne çdo kohë dhe kjo nuk përjashton obligimet tatimore që mund te lindin ne te ardhmen deri sa vlerësohet tenderi.

Mbesim me shpresë se kjo kërkesë nga KK Gjakovë do te hedhet poshtë nga paneli i OSHP-së pasi nuk ka asnjë arsye te zbatohet neni 99.2 LPP pasi qe ne nuk kemi bere falsifikim te dokumenteve dhe nuk kemi bere asnjë shkelje ligjore me rastin e aplikimit në këtë aktivitet prokurimi”.

Në bazë të autorizimit që kam nga OSHP mund të sqaroj se në bazë te nenit 99.2 të LPP-së, marrja e masave nga OSHP-ja, ndaj operatoreve ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit vjen në shprehje vetëm nëse konstatohet se operatori ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet te prokurimit ka prezantuar dokumente të falsifikuar, apo ka bërë paraqitjen e të dhënave te rreme ashtu siç parashihet me nenin 99.2. të LPP-së, në te cilin thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Lidhur me kërkesën e lartpërmendur, OSHP-ja nuk ka caktuar seancë dëgjimore pasiqë nga shkresat e lëndës është vërtetuar se provat e ofruara nga AK përbëjnë bazë të mjaftueshme për verifikim dhe analizimi të kërkesës, andaj mbajtja e seancës në këtë rast nuk ishte e nevojshme.

Paneli shqyrtues pas analizimit të shkresave dhe fakteve të lëndës, përgjigjes me parashtresën me shkrim të OE në fjalë, konstaton se AK ka kërkuar nga OE "MEGRANT ING" sh.p.k., vërtetimet nen lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë, për aktivitetin e prokurimit “Fuqizimi, montimi dhe ndërtimi me material për klasën verore në SHMFM Ukshin Miftari”, me numër identifikues: 632-22-3675-1-3-6. OE brenda afatit te kërkuar ligjor, nuk ka dorëzuar vërtetimin nga ATK se nuk ka obligime borxhe të tatimeve në ATK si dhe vërtetimin e lëshuar nga një Gjykatë kompetentë se kompania (biznesi) nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësor. AK- KK Gjakovë, ne përputhje me nenin 26.8 të RrUOPP-së, ka vazhduar me tenderuesin e listuar ne vendin e dytë, dhe ka kërkuar marrjen e masave ndaj OE në fjalë.

OE “Migrant” Ing përmes parashtresës me shkrim ka njoftuar se AK KK Gjakovë është vonuar me vlerësimin e ofertave dhe me datë 17.05.2022 ju ka dërguar kërkesën për vërtetimin tatimor si dhe vërtetimin e Gjykatës kompetente. Të njëjtit nuk i janë përgjigjur kësaj kërkesë për arsye se vërtetimi tatimor me nr. serik: 1000866654 i datës 15.02.2022 me vlefshmëri 90 ditë i ka kaluar

afati me datën 15.05.2022 kështu që OE ka hyrë ne obligime te reja tatimore dhe me këtë rast nuk kanë mundur te nxjerrim Vërtetim Tatimor pa borxhe.

Paneli shqyrtues sqaron se neni 26.8 të RRUOPP-së thotë: “Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se”. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, dhe në bazë të nenit 99 par 2 të LPP-së, paneli shqyrtues vlerëson se nuk qëndron arsyetimi i OE “Migrant ING”, sa i përket vonesës së vlerësimit të ofertave nga ana e autoritetit kontraktues Komuna Gjakove, sepse sipas legjislacioni në fuqi për prokurimin publik vlerësimi i ofertave duhet të bëhet brenda afatit prej 30 ditëve, kështu që vlerësimi i ofertave është brenda afateve ligjore, këtë e konfirmon edhe vetë OE në shkresën drejtuar OSHP-së me dt. 07.06.2020, ku shkruan se “dorëzimi i ofertave ka qenë me 04.05.2022, ndërsa kërkesa për vërtetimin tatimor dhe vërtetimin e Gjykatës kompetente ka qenë me dt.17.05.2022”, kërkesë kjo që bëhet vetëm për OE fitues, që i bie se vlerësimi i ofertave është bërë brenda 12 dite dhe brenda afatit ligjor. Andaj, PSH vendos se OE “Migrant ING” të diskualifikohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik në periudhë prej tre muaj nga data 22.09.2022 deri me 22.01.2023.

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Gjakovë

1x1 OE “Migrant ING”

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së

